



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 33-të të KPF-së e mbajtur, më 28.06.2021, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Hyra Bytyçi, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani
4. Albulena Kelmendi, anëtare
5. Ukë Kryeziu, anëtar
6. Afrim Miftari, anëtar
7. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, DGJK
3. Bekim Shabani, DEZH
4. Latif Ramadani, DBF
5. Valon Pacolli, DA
6. Merita Bytyqi, DSH

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 32 – të.

2. Propozim Vendim për aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2022-2024

3. Propozim rregullore për transparencën në komunë

4. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë të komunitetit në vendbanimin në Gandime të Ulët.

5. Propozim rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve.

6. Propozim rregullore për taksat komunale

7. Propozim Vendim për anulimin e vendimit 15Nr .30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore " Afrim Zhitia " , " Mbreti Zog " dhe " Kongresi i Blinajës " në Lipjan .

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se me kërkesë të kryetarit të komunës kemi një pikë shtesë, Propozim vendim për ridestinimin dhe transferim e mjeteve për vitin 2021

Lumturije Btyqyi-Hasani,unë e kam një propozim që të jetë pikë shtesë propozim vendimi për zgjedhjen e këshillave të fshatrave i cili ka mbet në gjysmë, po ashtu edhe propozimi tjetër që të zëvendësohet anëtar i komisionit nga ekzekutivi.

Daut Azemi,ne do ta kemi edhe një mbledhje prapë në qershor dhe do të jetë kjo pikë, por do të bisedoj me zyrën ligjore do të shohim a është e mundur që të përgatitet për këtë mbledhje.

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Me që vërejtje apo plotësime nuk pati kryesuesi e hodhi në votim dhe me të gjitha votat prezentë u konstatua se KPF-ja e kaloi rendin e ditës së propozuar!

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 32-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 32-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Propozim Vendim për aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2022-2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Latif Ramadani, , drejtor i DBF, I cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Hyra Bytyçi, unë kam marr pjesë në disa dëgjime buxhetore dhe po e shoh që kërkesat e qytetarëve janë marr parasysh po ashtu edhe ato të kryetarëve të këshillave të fshatrave. Kam një pyetje pse disa projekte kanë shumën zero. A do të ketë rritje të pagave apo pse janë me të mëdha shumat.

Lumturije Bytyqi-Hasani, unë nuk shoh ndonjë ndryshim nga vitet e kaluara,nëse e shohim të shëndetësia kemi shumë të vogël të mjeteve vetëm 31 mijë euro. Po ashtu të arsimi ka qenë e planifikime çerdhja në Shalë tash është shty për vitin 2023. Po ashtu të përfundohen edhe disa rrugica të cilat kanë mbetur në fshatin Shalë. Është mirë që edhe për pagat jubilarë shuajtet ditore dhe 3 pagat e përcjelle të behet një zgjidhje jo të shkojnë përmes procedurave gjyqësore.

Ukë Kryeziu,unë kam marr pjese në disa dëgjime buxhetore dhe kam dhënë propozimet e mia e të cilat po i përsërisë prapë e para në Sllovi është mirë që ambulanca të behet QMF dhe të përfshihen edhe fshatrat që janë afër të vijnë në Sllovi. Po ashtu është mirë të specifikohen me emër se cilat rrugë do të asfaltohen po ashtu në cilat rrugë do të behet ndriçimi publik. Është mirë që rruga Sllovi Lipjan të rikonstruktohet dhe ti behet një zgjidhje banorëve të asaj pjese pasi që sa kohë ajo rrugë është në gjendje jo të mirë. Ne jemi që kjo pike të shkojë në Kuvend.

Afrim Miftari,një buxhet i bazuar në kërkesat e qytetarëve ,por unë i kam për ti ngritur edhe disa kërkesa të cilat janë ngritur në dëgjimet buxhetore në Gadime,ku shumica kanë qenë rreth kanalizimit rrugicave e ndriçimit. Kërkesë e banorëve të fshatit mareve ka qenë trotuari me ndriçim publik për shkak të kalimit të nxënësve për në shkollë të asaj rruge.

Albulena Kelmendi, pajtohem me parafolësit nga opozita për ato që i than, e sidomos për shëndetësi, në si grup qëndrimet tona i epin në seancën e kuvendit .Po

ashtu sa i përket kërkesave qytetareve është kërkesë edhe e punëtorëve të arsimit për paga jubilarë dhe shujtë ditore pasi që në disa komune veç i kanë marrë.

Latif Ramadani,sa i përket pagave jubilarë atë kontratë e ka nënshkruar ministria dhe sindikatat dhe është përgjegjësi e tyre. Kryetari e ka adresuar disa here këtë çështje.Ky buxhet është bazuar në bazë të kërkesave të qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore të cilat i kemi marrë. Ndërsa sa i përket shëndetësisë ministria e ka ulë grandin specifik të shëndetësisë veç ato mjete na ka lejuar për shëndetësi.

Daut Azemi, ne e kemi pas obligim me ligj me i mbajtur dy dëgjime buxhetore me kuvend e anëtarët e komiteteve dhe qytetarët dhe këshillat e fshatrave dhe i kemi mbajtur.

Hyra Bytyçi, une kam marrë pjesë në disa dëgjime buxhetore dhe po e shoh që janë marrë parasysh kërkesat e qytetarëve dhe ne e përkrahim këtë propozim vendim

Pastaj Kryesuesi vuri në votim propozimin që të kalojë direkt në kuvend,me të gjitha votat për këtë pikë..

III

Propozim vendim për ridestinimin dhe transferim të mjeteve për vitin 2021.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Latif Ramadani , drejtor i DBF, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, si duket janë mjete që janë shkuar kryesisht në ndriçim publik dhe asfalt. Ka qenë një kërkesë e banorëve të fshatit Akallap në dëgjime buxhetore për rregullimin e një rrugë e cila qon deri te varrezat e fshatit por nuk është në këtë propozim.

Ukë Kryeziu, nuk po e shoh që është diku pastrimi i lumit në Sllovi nuk e di a është parapa të pastrohet a jo.

Fehmi Rexhepi, disa rrugë në fshatin Medvec kanë mbetur të pa asfaltuara, po ashtu një pjesë e komunitetit kanë mbetur pa kanalizim në fshatin Magure.

Latif Ramadani,ne Akllap ka pasë kërkesë edhe për ndërtimin e disa urave të cilat për banorët kanë qenë me të nevojshme por do të përfshihet edhe rrugica të varrezat. Kanalizimi në Magure dhe rrugicat në Medvec shumë shpejt do të fillojnë. Sa i përket lumit në Sllovi nuk e di.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë të komunitetit në vendbanimin në Gandime të Ulët.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Sefer Tashollit , drejtor i DGJK, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Lumturije Bytyqi-Hasani, une sa kam qene kryesuese e komitetit për komitete e pata vizituar disa here ato familje ne Gadime dhe e kam pa qe ato shume kane nevojë per ndihmë. Për çka konkretisht do te jetë kjo?

Sefer Tasholli, ky objekt do te jetë per komunitet RAE, për nevojat e këtij komuniteti për mbledhje dasma te pame tjera.

Afrim Miftari, ne Gadime mburremi me at komunitet qe e kemi dhe kemi raporte shume te mira është mirë qe po ndërtohet kjo por ka nevojë qe aty te behet edhe banim kolektiv për ata banorë. Ne e përkrahim këtë propozim vendim.

Hyra Bytyçi, e falënderoj Vorae per bashkëpunimin qe ka pasur me komunën tonë,do te ishte mire qe edhe në fshatin Medvec te jetë një e ngjashme sikur kjo. Ne e përkrahim këtë propozim vendim.

Lulzim Qerimi, kjo do te jetë një shtëpi për nevojat e komunitetit dhe unë ju falënderoj te gjithëve për përkrahjen qe po e bëni,do te jetë një bashkëpunim ne mes te organizatës Vorae dhe Komunës së Lipjanit. Ndërsa ne Medvec është një shtëpi e ngjashme e ndërtuar nga bashkë atdhetarët.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim rregullore për transparencën ne komunë

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i a dha fjalën, Valon Pacollit DA i cili , e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim rregullorja.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Lumturije Bytyqi Hasani, sa i përket kesh rregullore unë kam disa vërejtje për zyrën e informimit e cila asnjëherë nuk e pasqyron punën e kuvendit por vetëm punën e ekzekutivit po ashtu edhe te videot e mbledhjeve te kuvendit shpesh here ka ndërprerje. Dhe cilat ndryshime janë bere ne këtë rregullore

Daut Azemi, ne disa mbledhje qe ka pas probleme me video ajo ka ndodh për shkak te rrjetit qe është dëmtuar gjate punimeve ne rrugën 4 kursi.

Valon Pacolli, janë bërë disa ndryshime te cilat i ceka me herët dhe besoj qe tani do te zbatohet kjo rregullore.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Merita Bytyqi drejtoreshë i DSH, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, me herët kjo rregullore nuk ka pas bazë juridike dhe ne si grup i PDK-s e kemi kundërshtua këtë rregullore. Por tani përkrahim këtë rregullore tani dhe shpresojme qe ne praktike do te zbatohet.

Merita Bytyqi, ne këtë rregullore ka punuar një grup nga qendra për pune sociale zyra ligjore dhe kane bere një pune te mire. Përgjegjëse do te jete qendra për pune sociale.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim rregullore për taksat komunale

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit drejtor për EZH ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari ,kam një pyetje këtu te neni 6 pika 5 e kësaj rregullore janë disa masa për kuajt dhe gomaret po me duket jo e arsyeshme edhe ashtu gati ne zhdukje këto a kish pas mundësi të jenë me te vogla.

Lumturije Bytyqi-Hasani, pse nuk është e bashkangjitur shkresa e ministrisë me te cilën është kundërshtuar konfirmimi i ligjshmërisë.

Bekim Shabani, këto masa janë të caktuara nga Ministria. Ndërsa sa i përket shkresës së ministrisë ne mbledhjen e kuvendit do ta keni te gatshme.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VIII

Propozim Vendim për anulimin e vendimit 15Nr .30-30026 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore “ Afrim Zhitia ” , “ Mbreti Zog ” dhe “ Kongresi i Blinajës ” në Lipjan .

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Merita Bytyqi drejtoreshë i DSH,i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Lumturije Bytyqi-Hasani, me sa e pash unë këtu ka kolizion te ligjeve ku ministritë po bëjnë eksperimente me komuna.

Sefer Tasholli, ministria ka thënë që organ shpronësues është Kryetari dhe po donë përgjegjësinë me ja bart kryetarit.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16,³⁵

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi